



RAPORT MONITORIMI  
**KULTURA**  
Maj-Korrik 2020



AUTOR  
**Erisa Kryeziu**



## Ministria e Kulturës në “karantinë” ndaj shkatërrimit të trashëgimisë kulturore

Në orët e para të së djelës së 17 majit 2020, policia ndërhyri në ambjentet e Teatrit Kombëtar, duke nxjerrë nga godina aktivistët që prej dy vitesh qëndronin në ambjentet e tij për ta mbrojtur nga shembja.<sup>1</sup> Pa zbardhur akoma dita, Teatri Kombëtar u shemb, duke sjellë në shesh grumbullimin e qindra qytetarëve në shenjë proteste, edhe pse ishim në kushte pandemie dhe thirrjet për të qëndruar në shtëpi dhe distancim social ishin akoma në nivel të lartë.

Megjithatë, përpos aktit të shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar, një çështje që ngriti një diskurs të gjerë publik me argumente dhe kundër argumente për rëndësinë e godinës, institucioni i cili direkt ose indirekt e kishte në ngarkim mbi rëndësinë kulturore të aktiviteteve që zhvillon dhe godinës që përfaqëson Teatri, ishte edhe Ministria e Kulturës. Megjithatë nëse do të analizojmë komunikimin **e Ministrisë së Kulturës përmes faqes së saj zyrtare shohim se nuk ka asnjë reagim për këtë çështje, qoftë kjo në mbështetje ose jo të shembjes së godinës.**<sup>2</sup> Me një vendim të Këshillit të Ministrave të datës 8 maj 2020, me propozim të Ministrisë së Kulturës, Teatri dhe trualli i tij prej 5 522 metrash katrorë i kalojnë në pronësi bashksië Tiranë, duke hequr kështu çdo përgjegjësi të ministrisë përkatëse mbi këtë çështje.

<sup>1</sup> <https://citizens-channel.com/2020/05/17/klithmat-e-fundit-te-teatrit-kombetar/>

<sup>2</sup> <https://citizens-channel.com/2020/05/12/trualli-i-teatrit-i-kaloi-bashkise-cfare-u-fol-me-pas-reagime-dhe-kunder-reagime/>




Mos reagimi dhe refuzimi për të mbajtur pozita të caktuara në debatet publike për çështje që i përkasin aspektit kulturor dhe të trashëgimisë, pasohet më pas me vonesë në reagim në rastin e dëmtimit të dy kolonave të parkut arkeologjik të Apolonisë.



Më 12 qershor 2020 në media u bë publik dëmtimi i dy kolonave të lashta të Fontanës Monumentale të Apolonisë. Për këtë lajm Ministria e Kulturës reagoi vetëm më 15 qershor 2020, si kundërpërgjigje ndaj reagimeve publike për fshehje të ngjarjes.<sup>3</sup> Ky reagim u postua në faqen web të Ministrisë Kulturës një muaj më vonë nga reagimi në Facebook, më 17 korrik 2020.

*“Ministria e Kulturës nuk ka bërë asnjë përpjekje për të fshehur dëmtimin e dy kolonave të fasadës së fontanës monumentale të Apolonisë, por ka ndjekur rrugën ligjore për zbardhjen e këtij akti vandal dhe ka marrë masa të menjëhershme për hartimin e projektit për ringritjen e tyre. Puna për ringritjen e kolonave dhe restaurimin e tyre do të nisë në ditët në vijim”, - shkruan ministrja Margariti, dhe më pas ky reagim shpërndahehet në faqen e Ministrisë së Kulturës në rrjetin social “Facebook”.*



<sup>4</sup>Kontekstualizimi i këtij rasti me atë të Teatrit bëhet për shkak se Ministria nuk reagon ose në rastin e fundit reagon me vonesë për çështje që janë në tagrin e saj. Edhe me shembjen e kolonave në Apoloni **reagimi i Ministrisë ishte më datë 15 qershor, pra 2 muaj më vonë nga procesverbali që konfirmon dëmin nga ana e Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis**. Me anë të një kërkesë për informacion drejtuar Ministrisë së Kulturës, ku iu kërkuar procesverbali i konstatimit të dëmeve, vihet re se ngjarja ka ndodhur më 11.04.2020 në orën 10 të mëngjesit, ndërsa procesverbali/relacioni mbi dëmin e konstatuar është kryer dy ditë me vonesë, përkatësisht më datë 13.04.2020.

<sup>3</sup> <https://kultura.gov.al/deklarate-per-shtyp-mbi-demtimin-e-kolonave-te-fasadës-se-fontanes-monumentale-te-apolonise/>

<sup>4</sup> Fotoja pasqyruese është përgjigja që Ministria ka dhënë ndaj kërkesës sonë për informacion. Në monitorimin e dytë, kjo temë do të shtjellohet më shumë, në lidhje edhe me kompanitë e kontraktuara për ruajtjen e monumenteve dhe parqeve arkeologjike në vend.



## Si komunikon Ministria e Kulturës me qytetarët në faqen zyrtare në rrjetin social “Facebook”?

Zhvillimi i platformave të komunikimit ka sjellë edhe orientimin e komunikimit publik e zyrtar në drejtim të këtyre platformave. Rrjeti social Facebook është një ndër hapësirat që shërben për të adresuar informacione për çështje të caktuara, për të orientuar lexuesit, apo për të shpërndarë punën e kryer nga institucionet shtetërore. <sup>5</sup>Ministria e Kulturës, sikurse shumë institucione të tjera publike zotëron një faqe në rrjetin social Facebook, teksa ka marrë pëlqimin e 22,919 personave, ndërsa ndiqet nga 23161 të tjerë.

Ndryshe nga institucionet e tjera ku periodiciteti i shpërndarjes së informacioneve në faqet e tyre është më i shpeshtë, në faqen e Ministrisë së Kulturës frekuenca e postimeve brenda një dite është modeste, duke nisur nga ditë me një postim, deri në ditë me maksimumi tre postime, e për të përfunduar te tre ditë radhazi pa asnjë informacion të bërë publik.

Ajo ç’ka vihet re më së shumti në politikën e komunikimit publik veç të tjerash është edhe burimi i informacionit. Prandaj edhe arsyeja pse po merret në **monitorim kjo faqe është mënyra se si shërben faqja zyrtare e ministrisë në Facebook**. Trendi është që faqja e Ministrisë së Kulturës të mos jetë një faqe që prodhon vetë informacionin, që do të thotë informacioni i parë për tematika kulturore dhe të trashëgimisë të mësohen nga kjo faqe, por të shërbejë si një kanal transmetues i të dhënave që burimin e kanë diku gjetkë, **në rastin konkret në faqet zyrtare të vetë drejtuesve të institucionit, pra të vetë ministres Elva Margariti**.



Elva Margariti

Page · Tërana, Albania · Public Figure · MargaritiElva · 12K like this



Ministria e Kulturës

Place · Government Organization  
1.6 mi · Aleksander Moisiu 76 · Tërana



Ministër i Kulturës



Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Kulturës, Republika e Shqipërisë.

Në fakt kjo është një strategji dominuese e qeverisë aktuale, pasi e njëjta formë komunikimi është edhe për ministrinë e tjera apo institucione të tjera, ku faqet zyrtare thjesht shpërndajnë informacionin e publikuar së hershmi në faqet personale të drejtuesve.

Për të kuptuar fluksin e postimeve në faqen e ministrisë dhe për të kuptuar orientimin dhe burimin e tyre kemi kryer monitorimin tre mujor, nga muaji maj deri në korrik 2020.

<sup>5</sup> <https://www.facebook.com/Ministria-e-Kultur%C3%ABs-1426548810890957/>





## Monitorimi i informacionit të përcjellë nëpërmjet Faqes zyrtare Facebook dhe Web të Ministrisë së Kulturës

### Në Facebook

Nga monitorimi 3 mujor, përkatësisht në muajt maj, qershor dhe korrik 2020, fluksi i postimeve në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës në rrjetin social Facebook varion në:

**Maj** - Nga 40 postime, 27 postime kanë burim informacioni faqen personale të Ministres së kulturës Elva Margariti, pra janë si shpërndarje nga faqja e saj, vetëm 8 postime janë të vetë Ministrisë së Kulturës. Këto postime kryesisht janë të llojit, ndryshim foto cover-i, urime ditëlindjesh për personalitete të artit, njoftime për homazhe pas vdekjes si dhe ngushëllime të shprehura për largimin nga jeta e personaliteteve me rëndësi në kulturën shqiptare.

Maj 2020		Gjithsej postime: 40
Nr i postimeve	Burimi i postimeve	
<b>27 postime</b>	Faqja personale e ministres Elva Margariti	
<b>2 postime</b>	Faqja zyrtare e Teatrit Kombëtar të Opera dhe Baletit	
<b>1 postime</b>	Faqja zyrtare e Muzeut Historik Kombëtar	
<b>8 postime</b>	Nga vetë Ministria e Kulturës	
<b>2 postime</b>	Faqja e Kryeministrit Rama	

**Qershor** - Nga këto 51 postime, 45 postime kanë burim informacioni faqen personale të ministres së kulturës Elva Margariti, vetem 3 postime janë të bëra nga vetë Ministria e Kulturës, edhe këto me karakter bazik.

Qershor 2020		Gjithsej postime: 51
Nr i postimeve	Burimi i postimeve	
<b>45 postime</b>	Faqja personale e ministres Elva Margariti	
<b>2 postime</b>	Faqja zyrtare e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit	
<b>1 postim</b>	Faqja e Kryeministrit Rama	
<b>3 postime</b>	Nga vetë Ministria e Kulturës	

**Korrik - 41 postime** Nga këto 41 postime, 38 janë të shpërndara nga faqja personale e ministres së kulturës, Elva Margariti, nderkohe 1 postim nga vetë Ministria e Kulturës, që është veçse ndryshimi i fotos së cover-it.

Korrik 2020		Gjithsej postime: 41
Nr i postimeve	Burimi i postimeve	
<b>38 postime</b>	Faqja personale e ministres Elva Margariti	
<b>1 postim</b>	Faqja zyrtare e Teatrit kombëtar të Operas dhe Baletit	
<b>1 postim</b>	Fazja e Kryeministrit Rama	
<b>1 postim</b>	Nga vetë Ministria e Kulturës	

## Në web

Përpos komunikimit në rrjetin social Facebook, komunikimi i Ministrisë së Kulturës bëhet edhe në faqen e saj zyrtare web. Kështu, nëse në rrjetin social Facebook veprimtaria e Ministrisë ndiqet nga 22 mijë persona, ata të cilët nuk e ndjekin në rrjetin social Facebook duhet të kenë mundësi të informohet nëpërmjet faqes web të kësaj Ministrie. Por sa informacion jep Ministria në web duke e krahasuar me atë të shpërndarë në rrjetin social Facebook. Nga vëzhgimi i faqes web, rezulton se ka 3 kategori ku mund të shpërndahet informacioni i veprimtarisë së Ministrisë, i njëjtë me atë në Facebook. Përkatësisht ekziston <sup>6</sup>kategoria e lajmeve, <sup>7</sup>kategoria e njoftimeve dhe kategoria e <sup>8</sup>deklaratave për shtyp.

**Nga vëzhgimi rezulton se për 3 muaj, maj, qershor dhe korrik të vitit 2020 në të treja këto kategori ka vetëm 18 postime me informacione.** Të ndara sipas muajve si më poshtë:

Kategoria “Lajme”	
Maj	1 postim
Qershor	0 postime
Korrik	8 postime

Kategoria “Njoftime”	
Maj	2 postime
Qershor	4 postime
Korrik	2 postime

“Deklarata për shtyp”	
Maj	0 postime
Qershor	0 postime
Korrik	1 postim

Sipas vëzhgimit, nëse nuk je një nga 22 mijë ndjekësit e faqes së Ministrisë në rrjetin social Facebook nga ku, nuk ke asnjë mënyrë tjetër informimi rreth veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës.

<sup>6</sup> <https://kultura.gov.al/category/lajme/>

<sup>7</sup> <https://kultura.gov.al/category/njoftime/page/2/>

<sup>8</sup> <https://kultura.gov.al/category/deklarata-per-shtyp/>






## Zbatimi i të drejtës së informimit nga Ministria e Kulturës

Për të kuptuar më qartë komunikimin e Ministrisë së Kulturës dhe qasjes që qytetarët kanë ndaj informacioneve të shpërndara prej këtij institucioni, mjafton të ushtrosh të drejtën qytetare që çdokush prej nesh ka për t'u informuar.<sup>9</sup> Referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, institucionet janë të detyruara për të dhënë informacione dhe për ti bërë ato publike edhe në rast kur nuk kërkohen përmes kërkesave të adresuara në mënyrë zyrtare.

Për të kuptuar se sa transparente është Ministria e Kulturës mjafton të bësh një kontroll të faqes së tyre zyrtare, për të vënë re publikimin e të dhënave të parashikuara në ligjin për të drejtën e informimit.<sup>10</sup>

Gjëja e parë që vihet re gjatë vizitës në web është fakti se faqja e Ministrisë së Kulturës të dërgon në disa klikime për të gjetur informacionin. Kjo pasi në momentin që klikon në një kategori, ndeshesh me tog fjalëshin **“Sorry, this entry is only available in AL”**. Vetëm nëse klikon sërish në shkonjat AL mund të drejtohesh në informacionin që po kërkon. Për një kërkues të mprehtë në internet mund të jetë e lehtë, por për qytetarë të tjerë, kjo mund të sjellë vështirësi në orientim.



**Referuar nenit 7 të ligjit “Për të drejtën e informimit”, ka disa kategori të cilat vihen në dispozicion të qytetarëve pa nevojën për kërkesë të posacme për informacion. Për të parë respektimin e këtij neni, nga monitorimi rezulton se:**

1.<sup>11</sup>Të dhënat për arsimin, pagat dhe funksionet që mbartin zyrtarët e Ministrisë së Kulturës janë të

paraqitura në faqe, por datojnë që në periudhën kur në krye të ministrisë ishte Mirela Kumbaro Furxhi.

2.<sup>12</sup>Ka një organigramë (zakonisht kjo është e njëjtë dhe nuk lipset të ndryshojë edhe me ndryshimin e drejtuesve)

3.<sup>13</sup>Ka të dhëna për ndarjet e drejtorive dhe personat udhëheqës të tyre, por nuk janë të rifreskuara dhe në disa prej tyre mungojnë emrat e drejtuesve të drejtorive.

4. Është publike struktura e pagave për punonjësit e Ministrisë

<sup>9</sup> <http://qkb.gov.al/media/1136/ligji-119-2014-per-te-drejte-e-informimit.pdf>

<sup>10</sup> <https://kultura.gov.al/>

<sup>11</sup> [https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/dhe\\_punonjes\\_qe\\_kane\\_detyrimin\\_per\\_deklarimin\\_e\\_pasurise.pdf](https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/dhe_punonjes_qe_kane_detyrimin_per_deklarimin_e_pasurise.pdf)

<sup>12</sup> [https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Organika\\_e\\_MK.pdf](https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/Organika_e_MK.pdf)

<sup>13</sup> <https://kultura.gov.al/drejtorite/>

5. <sup>14</sup>Janë publike konventat e ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

6. Ka të dhëna për koordinatorin për të drejtën e informimit, vendodhjen e insitucionit dhe adresën elektronike.

7. Sa i përket regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve rezulton të figurojë deri në mars të vitit 2020. Vlen të theksohet se fluksi i kërkesave është i pakët, ku nga tetori i vitit 2019 deri në mars të vitit 2020 ka vetëm katër kërkesa të bëra publike në regjistër. Neni 8 i ligjit për të drejtën e informacionit përcakton periodicitetin çdo tre muaj të përditësimit të këtij regjistri. Ndërsa për 3 muajin e fundit të deritanishëm, akoma nuk është bërë public ky regjistër.

8. <sup>15</sup>Referuar pikës dh. të nenit 7 të ligjit për të drejtën e informimit, për publikimin e raporteve të auditimit nga KLSH, vihet re se raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

nuk janë të fundit. Ato datojnë që prej vitit 2014, pra 6 vitet e fundit nuk kemi asnjë raport auditimi të bërë publik në faqen e Ministrisë së Kulturës.

9.<sup>16</sup>Edhe sa u përket raporteve të auditimit të brendshëm, më i fundit daton ai i vitit 2017.

10. <sup>17</sup>Buxheti i Ministrisë në programin e transparencës është publik deri në vitin 2017. Ndërsa nëse kërkon në kategoritë e rradhitura në krye të faqes, të seksioni I buxhetit, ai rezulton publik prej vitit 2014 dhe deri më 2022. Mirëpo raport për buxhetin ka vetëm për vitin 2019.

11. <sup>18</sup>Sa i përket bërjes publike të procedurave të prokurimit, sipas ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” dhe ligjin nr. 125/2013, “Për koncensionet dhe partneritetin publik privat”, nuk ka një të fillë. Është i aksesueshëm vetëm regjistri i prokurimeve për vitet 2016-2017.



<sup>14</sup> <https://kultura.gov.al/konventa/>

<sup>15</sup> <https://kultura.gov.al/raporte-auditimi-nga-klsh/>

<sup>16</sup> <https://kultura.gov.al/raporte-te-auditimit-te-brendshem/>

<sup>17</sup> <https://kultura.gov.al/programi-i-transparences/>

<sup>18</sup> <https://kultura.gov.al/buxheti/>





## Si komunikoi Ministria e Kulturës gjatë muajit Mars 2020, nisja e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19?

<sup>19</sup>Përgjatë muajit mars 2020, ndërsa në Shqipëri u shënuan rastet e para të personave të infektuar me virusin COVID-19 dhe masat shtrënguese u shtuan, duke mundësuar qëndrimin në shtëpi të të gjithë qytetarëve, Ministria e Kulturës në faqen e saj në Facebook ashtu sikurse të gjitha institucionet e ka orientuar komunikimin publik dhe institucional drejt masave dhe rreziqeve që sjell virusi COVID-19.



**Gjatë muajit mars 2020 ajo ç'ka vihet re më së shumti në faqen e Ministrisë së Kulturës është shpërdarja e çdo postimi të Kryeministrit Rama në lidhje me virusin COVID-19.** <sup>20</sup>Këto postime kanë qenë të llojit komunikime nga zyra, nga shtëpia, nga puna në terren, nga masat e marra, nga ndihmat në familje dërguar nga ushtria apo forcat e emergjencës civile etj.

Përgjatë gjithë muajit mars të vitit 2020 Ministria e kulturës ka qenë më aktive se kurrë me potim të informacioneve që lidhen me COVID-19. Ndaj përlogariten rreth 110 postime vetëm gjatë muajit Mars, të pazakonta për nga numri, marrë parasysh që në muajt e tjerë numrat e postimeve variojnë nga 40-50 postime gjithsej. Nga këto postime, 51 janë të shpërndara nga faqja e Kryeministrit Rama te faqja e Ministrisë së Kulturës. Ndërsa nga faqja e ministres së kulturës Elva Margariti janë 46 postime.

Mars 2020	Gjithsej 110 postime
<b>Nr postimeve</b>	<b>Burimi i postimeve</b>
<b>51 postime</b>	Faqja e Kryeministrit Rama
<b>46 postime</b>	Faqja e ministres Elva Margariti
<b>13 postime</b>	Nga vetë Ministria e Kulturës
<b>8 postime</b>	Nga faqet e artistëve që kanë ndarë mesazhe me publikun për të qëndruar në shtëpi
<b>4 postime</b>	Nga faqja e Teatrit Kombëtar
<b>1 postim</b>	Nga Ambasada e SHBA-së.

Informacioni i njëjtë me insitucionet e tjera i shpërndarë në faqen zyrtare të Ministrisë, ka qenë veçse zgjatim i informacionit të shpërndarë në faqen e Kryeministrit Rama, duke e njëtrajtësuar atë, duke e

shumëfishuar (shpërndarja e të njëjtit informacion në të gjitha faqet) dhe duke unifikuar natyrën e institucioneve shtetërore njësh me atë të Kryeministrit.

<sup>19</sup><https://euronews.al/al/vendi/2020/03/11/shenohet-viktima-e-pare-me-covid-19-ne-shqiperi>

<sup>20</sup>Embed video: [click](#)



## Përfundime dhe rekomandime



Përballja me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19 e orientoi komunikimin publik dhe institucional drejt pasojave që sjell virusi dhe masave të ndërmarra për parandalimin e tij. Megjithatë, kjo nuk e ndaloi Qeverinë Shqiptare të çonte deri në fund angazhimin disa vjeçar për të prishur godinën e Teatrit Kombëtar, në periudhë pandemie, në orët e para të mëngjesit të datës 17 maj, duke nxitur protesta, për të cilat prej dy muajsh po luftohej të shmangeshin grumbullimet për të evituar rrezikun e COVID-19.



Ministria e Kulturës si një institucion direkt ose jo përgjegjës për godinën e prishur, nuk pati asnjë reagim, komunikatë gjatë kësaj periudhe, duke ja adresuar bashkisë Tiranë jo vetëm të drejtën e godinës dhe truallit, por edhe të drejtën e komunikimit publik për këtë godinë.



Komunikimi dhe reagimi i Ministrisë, mungon edhe më vonë kur u dëmtuan dy kolona të parkut arkeologjik Apoloni, gjatë pandemisë. Informacion i raportuar dy muaj më vonë nga mediat, dhe akoma më vonë reagimi nga Ministria.



Në faqen web të Ministrisë ka mungesa të informacioneve dhe përditësim të tyre, duke përfshirë pozicionet e stafit në ministri, relacionet për buxhetin, auditimet nga KLSH dhe auditimet e brendshme, procedurat e prokurimit për vitet e fundit që janë në mungesë, dhe deri te përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për informacion.



Faqja zyrtare në Facebook rezulton se komunikimi është hierarkik, nga lart poshtë, dhe faqja e ministrisë nuk është gjë tjetër veçse kanal shpërndarës i informacioneve të bëra publike fillimisht në faqen zyrtare të vetë ministres Elva Margariti.



Gjatë nisjes së pandemisë, në muajin mars, faqja e Ministrisë së Kulturës në rrjetin social Facebook më së shumti ka shërbyer si kanal transmetimi i postimeve të kryera nga Kryeministri Edi Rama, duke qenë një zgjatim dhe shumëfishim i të njëjtin informacion.



## Rekomandime:

Ministria e Kulturës duhet të bashkëngjisë informacionet më të fundit në faqen e saj Web, sa i përket buxhetit, auditimeve, të dhënave për stafin dhe regjistrat e kërkesave dhe përgjigjeve për informacion, pra të zbatojë ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

---

Komunikimi në rrjetin social Facebook duhet të jetë institucional, duke pasur burim informacioni të dhëna të postuara direkt nga Ministria, pa dashur të jenë postimet vetëm të shpërndara nga ministrja që drejton insitucionin. Përmes këtij komunikimi i jepet përparësi kultit të individit, burim informacioni është ministrja dhe jo insitucioni publik, në këtë rast Ministria e Kulturës, ç’ka zbeh rolin e insitucionit dhe forcon atë të individit udhëheqës.

---

Informacionet e shpërndara në rrjetin social Facebook duhet të jenë të bashkangjitura edhe në faqen web të Ministrisë, me qëllim informimin e atyre qytetarëve që nuk kanë akses në Facebook, apo që duan të informohen në këtë lloj forme.

---

Ministria e Kulturës është dhe duhet të jetë një institucion i rëndësishëm në vend, duke pasur parasysh pasurinë kulturore, arkeologjike dhe trashëgiminë e vendit tonë. Për këtë arsye edhe komunikimi publik për çështje me rëndësi në këtë fushë duhet të jetë më i shpeshtë, më i fuqishëm. Mos reagimi, apo reagimi me vonesë për çështje të rëndësishme (së fundmi shembja e Teatrit Kombëtar dhe dëmtimi i dy kolonave në Apoloni), e pasqyron të pafuqishëm këtë institucion përballë atyre që kanë kryer këto akte vandalizmi, duke krijuar zonën e rehatisë për përsëritjen e tyre.

# #QËNDRESË MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.



[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

RAPORT MONITORIMI  
**Kultura**  
Maj-Korrik 2020